

BËHU  
BËHU  
STUDIO

UP  
INXHINIER  
PRODHIMTARI  
DHE INXHINIERI  
INDUSTRIALE  
ME MENAXHMENT



1000 €

BURSË E GARANTUAR NGA  
MASHT PËR TË GJITHA VAJZAT



## HISTORIKU

Bazat e themelimit të studimeve teknike, pra edhe të atyre të makinerisë, u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në Prishtinë, më 20 tetor 1961. Kjo shkollë kishte tri drejtime: Makinerinë, Elektroteknikën dhe Ndërtimtarinë

## MISIONI

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA" aftëson studentët nga lëmitë e inxhinierisë mekanike, të industrisë, teknologjisë, transportit, etj. për tregun e punës; kontribuon në zhvillimin shkencor, punën kërkimore dhe edukative, bashkëpunimin me ekonominë, me institucione-kompani publike dhe private duke realizuar punë shkencore - hulumtuese, projekte zhvillimore dhe profesionale në fushën e inxhinierisë mekanike dhe industrisë.



## FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

PROGRAMI I STUDIMIT  
BACHELOR

PRODHIMTARI DHE  
INXHINIERI INDUSTRIALE  
ME MENAXHMENT

# VIZIONI

Vizioni i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike është që të jetë i njohur në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar në ofrimin e arsimit të inxhinierisë mekanike, duke çuar në inxhinierë të kualifikuar, të cilët janë inovativë, kontribues në profesionin e tyre dhe të suksesshëm në studimet e avancuara, duke promovuar programe akademike që rrisin maksimalisht kontributet e UP-së në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Inxhinierët e mirë përgatitur të prodhimitarisë dhe inxhinierisë industriale me menaxhment gjejnë zgjidhje në fushën e inxhinierisë, ndryshojnë stilin e jetës së njerëzve me inovacione dhe invencione dhe ndikojnë në zhvillimin dhe prosperitetin e ekonomisë së një vendi dhe përshtatën me kohën moderne dhe me plot kuptimin e fjalës quhen krijues dhe artistë të së ardhmes dhe të tashmes.

Pozitat e mundshme të cilët mund ti zotërojnë në industri janë:  
projektimi, konstruktimi, prodhimi i detaleve, veglave dhe pajisjeve për nevoja të industrisë automobilistike, aviacionit, ushtarake, menaxhimi i prodhimit, menaxhimi i projekteve, menaxhimi i cilësisë dhe CEO i kompanisë.

## KONTAKTI

+383(0)38 552 126

Rruga Kodra e Diellit, p.n. 10000, Prishtinë  
fim@uni-pr.edu  
www.fim.uni-pr.edu

Gjatë studimeve studentët përdorin dhe operojnë me makina, instrumente dhe pajisje të ndryshme laboratorike siç janë makina për testimin e materialeve, torno, freza, presa, CNC torno dhe freza, robot industrial, skaner 3D, printer 3D, PLC etj.

Në aspektin inxhinierik studiohen një serë lëndësh të teknologjisë moderne dhe inteligjente të prodhimit siç janë përpunimi me prerje dhe deformim, saldim, sistemet prodhuese fleksibile ku përfshihen robotët e avancuar industrial dhe integrohen sensorët e ndryshëm.

Nga ana e menaxhimit studiohen një serë lëndësh duke përfshirë menaxhimin e projekteve, udhëheqjen, vendimmarrjen, duke i dhënë një kuptim kyç rolit dhe përgjegjësive të lidhshme.

